

Njoftim për pjesëmarrjen në konkurimin publik për qeradhënien e sipërfaqeve (shesh) prej 3 000 m² dhe 5 000 m² me qëllim depozitimin dhe kryerjen e aktiviteteve të përpunimit të mineraleve në portin e Durrësit.

Në zbatim të VKM nr 1712 datë 24.12.2008 "Për dhënien me qira ose enfitozë të pasurive shtetërore" Autoriteti Portual Durrës, shpall konkurimin për dhënien me qera të objektit "Sipërfaqe 3 000 m² dhe 5 000 m²" në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

Të dhëna për objektin dhe përdorimin.

Përshkrimi i sheshit: Sheshe të destinuara për depozitimin e mineraleve sipas Hartës së Administrimit të territorit të APD.

Vendndodhja: Sheshet e destinuara ndodhen në pjesën lindore të portit, sipas gent planit publikuar ne faqen e internetit www.apdurrës.com.al

Sipërfaqja: Sipërfaqja e këtyre shesheve është përkatësisht 3 000 m² dhe 5 000 m².

Afati i qeradhënies: parashikohet të jetë deri në 1 vit.

Veprimtaria që ushtrohet në objekt: Destinacioni i përdorimit të shesheve është depozitimi dhe kryerja e aktivitetit të përpunimit të mineraleve nga Kompanitë e Ngarkim – Shkarkimit (Egantia dhe ASC) në përputhje me kontratat licensë.

Mallrat që do të depozitohen nga qeramarrësi në këto sheshe duhet të jenë mallra që janë të destinuara për transport me anije .

Qeramarrësi duhet të përmbushë kërkesat përkatëse të legjislacionit Shqiptar dhe Të Ligjit dhe rregullat për Autoritetin Portual Durrës, si dhe të jetë në përputhje me rregullat dhe ligjet për respektimin e sigurisë (safety and security) dhe mbrojtjen e mjedisit.

Çmimi dysheme i qerasë :

Vlera dysheme e qerasë të jetë **2 lekë/m²/ ditë**.

Kriteret e vlerësimit:

Vlera e qerasë 100 pikë

Afati i dorëzimit të ofertave

Ofertat do të dorëzohen në datën **31.01.2011 ora 11.00** në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual Durrës.

Ofertat do të hapen më datë **31.01.2011 ora 11.00**, në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual në prani të komisionit të shqyrtimit të ofertave dhe subjekteve konkurruese.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë subjektet konkurruese:

- a) Kërkesa e subjektit për marrjen me qera.
- b) Plan Biznesi për vënien në funksionim të shesheve, ku bëjnë pjesë: Plani i përpunimit të mallrave gjatë kohëzgjatjes së kontratës për një vit, marrëveshje paraprake për përpunimin me subjekte të tjera përpunuese, mekanizmat e mjetet që do të shërbejnë për përpunim dhe tonazhin e mallrave që parashikojnë të përpunojnë.
- c) Ofertën mujore për tarifën e qerasë.
- d) Certifikatën e Regjistrimit të subjektit në QKR.

Për informacione të mëtejshme, Ju lutemi të kontaktoni në Drejtorinë Ekzekutive të Autoritetit Portual, Nr tel/ fax 052 223115 dhe faqen e internetit www.apdurre.com.al